


Ndërtesat informale në Tiranë



e verdhë - ndërtesa të parafabrikuara *e kuqe* - ndërtesa informale *blu* - ndërtesa me tulle të kuqe/të bardhë

Vitet pas '90-s njohën një lëvizje ekstreme të popullsisë drejt qyteteve, për kushte më të mira jetese, për më shumë mundësi arsimimi dhe punësimi. Qyteti i Tiranës e vuajti më shumë këtë fluks, që rezultoi në mbingarkesë urbane, sidomos në dekadën e parë pas rënies së regjimit komunist. Me rritjen e popullsisë në Tiranë, ajo që ndikoi menjëherë në strukturën urbane ishte shpërhapja e ndërtesave të banimit. Procesi ishte aq i shpejtë, sa që ekspertët dhe profesionistët e planifikimit urban nuk arritën të jepnin një zgjidhje të qëndrueshme, gjë që rezultoi në një shpërhapje të pakontrolluar të vendbanimeve të ulëta informale, kryesisht në zonat periferike të qytetit.

Qendra e qytetit gjithashtu u pushtua nga ndërtesa të larta të paplanifikuara. Silueta e qytetit me ndërtesa të ulëta, dhe në disa zona me lartësi maksimale prej 5-6 katesh, ndryshoi krejtësisht, duke krijuar një atmosferë të përzier, pa asnjë rregull për lartësitë e ndërtesave, orientimin e tyre apo afërsinë me njëratjetrën.

Kjo periudhë shënon një shpërthim në sektorin e ndërtimit, megjithëse u përqendrua më shumë në banesat private dhe jo në ndërtesa me apartamente. Shumica e shtëpive private ishin ndërtuar pas vitit 1960, por kulmin e arritën në vitet 1991–2000, me ndërtimin e 22% të tyre. Ritme të larta ndërtimi u vunë re edhe në dekadën e parë të shekullit 21 (19%); ndërkohë rreth 18%* e shtëpive private janë të pabanuara. Është e vështirë të përcaktohet shtrirja e kësaj kategorie në të gjithë strukturën urbane, pasi ndërtimet që i përkasin kësaj periudhe gjenden si në qendër të qytetit, ashtu dhe në periferi. Sidoqoftë, periferia paraqet një situatë më problematike për sa i përket materialeve të dobëta të ndërtimit, të ardhurave të ulëta dhe rehatisë në banesa. Kjo tipologji ndërtesave paraqet shumë problematika, për shkak të natyrës së ndërtimit: materiale ndërtimi të dobëta, projektim jo i duhur, përdorim minimal i izolimit dhe shpesh mungesë ekspertize profesionale gjatë procesit të ndërtimit. Kjo kategori banohet kryesisht nga familje me të ardhura të ulëta, çka reflektohet në zgjedhjen e materialeve dhe kapacitetin për të përballuar ndërhyrje rikonstruksioni.

Referenca

ESMAP, T. E. (2014). Improving Energy Efficiency in Buildings. Energy Efficient Cities. The World Bank Group.

SLED. (2015). Tipologjia e stokut të ndërtesave të banimit në Shqipëri dhe modelimi i shndërrimit të tyre për shkarkime të ulëta karboni në të ardhmen. Tiranë: Qendra Rajonale e Mjedisit për Evropën Qendrore dhe Lindore (REC).

Strategy Series, L. G. (2018). Energy Efficiency in Affordable Housing. A Guide to Developing and Implementing Greenhouse Gas Reduction Programs. U.S. ENVIRONMENTAL PROTECTION AGENCY.